

VENDIM
Nr. 756, datë 19.12.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115, datë 3.12.2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3.6, të vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.7, me këtë përmbajtje:

“3.7. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2025, në masën 18 584 271 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2025, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama